VENDIM
Nr. 202, datë 12.12.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E "DRAFTRREGULLORES SË PROFILEVE TË STANDARDIZUARA TË NGARKESËS"

Në mbështetje të neneve 16; 69, germa "f"; 86, pika 6, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, neneve 15 dhe 26 të "Rregullores të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 114/3 prot., datë 3.12.2019, të hartuar nga drejtoritë teknike, në lidhje me draftin e "Rregullores për profilet e standardizuara të ngarkesës",

konstatoi se:

- OSHEE sh.a., në zbatim të nenit 69, germa "f", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, harton profile të standardizuara të ngarkesës për kategori të caktuara klientësh, në rast se të dhënat e matjeve, të nevojshme për llogaritjen e disbalancave, nuk janë të disponueshme.
- Me qëllim përmbushjen e këtij detyrimi nga OSHEE sh.a., ERE me ndihmën dhe konsulencën e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe USAID-i, ka punuar për draftimin e rregullores së profileve të standardizuara të ngarkesës për kategori të caktuara klientësh, në rastet kur të dhënat e matjeve, të nevojshme për llogaritjen e disbalancave, nuk janë të disponueshme.
- Me shkresën nr. 525, datë 2.9.2019, ERE i ka vënë në dispozicion shoqërisë OSHEE sh.a. për opinione dhe komente me afatin deri më 20 shtator draftin e kësaj rregullore së bashku me komentet e ERE-s dhe USAID-it.
- OSHEE sh.a., me shkresën nr. 525/1, datë 23.9.2019, ka përcjellë në ERE komentet lidhur me draftrregulloren e profileve të standardizuara, si dhe ka kërkuar organizimin e një seance dëgjimore lidhur me diskutimin e këtij drafti.
- Në këtë shkresë OSHEE sh.a. ka paraqitur edhe problematikat e sistemit dhe vështirësitë për përcaktimin dhe implementimin e profileve të standardizuara të ngarkesave të tilla.
- ERE, me shkresën nr. 525/2 njofton organizimin e një seance dëgjimore teknike për profilet e standardizuara të ngarkesave, duke marrë shkas edhe nga kërkesa e OSHEE sh.a., duke theksuar edhe njëherë rëndësinë e kësaj rregulloreje, në kushtet e përfundimit të instalimit të matësve Smart në nivel tensionin 35 kV, si dhe para hapjes së tregut të energjisë.
- Nga ana e OSHEE sh.a. në këtë seancë u ritheksuan edhe njëherë problematikat e përmendura në shkresë dhe u kërkua pjesëmarrja e OST-së në seancë, duke qenë se të dhënat e matjes për tensionin 35 kV vijnë nga OST-ja.
- ERE, me shkresën 651, datë 17.10.2019 kërkoi nga ana e OSHEE sh.a. që brenda datës 21.10.2019 të paraqesë në ERE draftkomentet përfundimtare për rregulloren, si dhe propozimin për hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje.
- OSHEE sh.a., me shkresën nr. 651/1, datë 21.10.2019, në vijim të seancës dëgjimore të datës 11.10.2019, dërgoi sërish komente për draftrregulloren dhe kërkoi edhe pjesëmarrjen e shoqërisë OST sh.a. në një seancë dëgjimore.
- ERE me shkresën 525/3 njofton organizimin e një seance dëgjimore teknike për profilet e standardizuara të ngarkesave, me pjesmarrjen e OSHEE sh.a., OST sh.a., MIE, Shoqatës së Mbrojtjes së Konsumatorit Shqiptar, Zyrës për Mbrojtjen e Konsumatorit, Shoqatës Konsumatori në Fokus dhe Dhomës së Tregtisë të Industrisë.
- Në seancë morën pjesë vetëm përfaqësues të MIE-së, OST sh.a. dhe OSHEE sh.a.

- Në vijim të seancës dëgjimore të datës 1.11.2019, OSHEE sh.a. u përgjigj me shkresën nr. 525/4, datë 8.11.2019, ku krahas komenteve të paraqitura në draft, ka kërkuar edhe ndryshime në draft rregullore.

- OST sh.a. u përgjigj me shkresën nr. 525/5, datë 18.11.2019, ku OST sh.a. sqaron se mbështet draftimin e profileve standarde të ngarkesës (PSN) nga OSHEE sh.a., si një detyrim i përcaktuar në ligj.

- Hartimi i profileve të standardizuara të ngarkesës për kategori të caktuara klientësh është i nevojshëm për të mundësuar hapjen e tregut të energjisë elektrike në vendin tonë. Konkretisht nëpërmjet profileve të standardizuara të ngarkesës dhe konsumatorët e energjisë elektrike te lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV mund të kërkojnë të furnizohen me energji elektrike në tregun e pa rregulluar.

- VKM nr. 253 datë 24.4.2019, përcakton se Shkëmbimi i planifikuar i energjisë në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike, do të realizohet me hapa gjatë tre viteve të ardhshme dhe do të sigurojë të gjitha sistemet, personelin dhe ndërveprimet e nevojshme për operimin e tregut të ditës në avancë të energjisë elektrike për të gjithë pjesëmarrësit e tregut. Realizimi me hapa, do të lehtësojë liberalizimin gradual të klientëve komercialë dhe familjeve në nivel të ulët tensioni (TU).

- Bazuar në më sipër kjo rregullore duhet të jetë në fuqi në momentin që parashikohet mundësia legale e realizimit të transaksioneve në Bursën Shqiptarë të Energjisë Elektrike. Kjo rregullore nëpërmjet së cilës do të përcaktohen profilet e standardizuara të ngarkesës do të mundësojë krijimin e kushteve teknike për mundësinë e daljes në tregun e pa rregulluar dhe të klientëve të energjisë elektrike të lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV.

- Duke marrë në konsideratë sa më sipër, si dhe VKM nr. 253, datë 24.4.2019, që përcakton se Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike në janar të vitit 2021 do të iniciojë testimin e plotë të tregut të ditës në avancë dhe të tregut ditor të energjisë elektrike, propozojmë hyrjen në fuqi në janar të vitit 2021 të Rregullores së Profileve të Standardizuara të Ngarkesës.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e "Rregullores për profilet e standardizuara të ngarkesës".

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti